

RAPORTI TEKNIK

**“NDËRTIM RRJETI SHPËRNDARËS UJËSJELLËSI
FSHATRAVE GJORICË DHE OSTREN SI DHE NDËRTIM
DEPO UJI BASHKIA BULQIZË”**

**PUNIMET E MBETURA PËR FAZËN E II_RRJETI
SHPËRNDARËS NË FSHATRAT ÇERENEC I SIPËRM DHE
ÇERENEC I POSHTËM DHE NDËRTIM DEPO UJI**

**SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME DIBËR SH.A
FAZA PROJEKT-ZBATIM**

Përgatitur nga:

Ekspert Mjedisi

Gezim ISLAMI

Përmbajtje

1. QËLLIMI I PROJEKTIT	3
2. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT TË PROPOZUAR.....	4
3. STRUKTURA E PROJEKTIT	Error! Bookmark not defined.
4. Programi për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar për funksionimin e projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe, sipas rastit, edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes, pas mbarimit të funksionimit të projektit.....	12
5. Lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyra e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji)	13
6. Informacioni për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zonës së projektit.....	13
7. Informacioni për alternativat e marra në konsideratë, për sa i takon përzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret	13
8. Të dhënat për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasi të ujit të dhe nevojshëm, të energjisë, lëndëve djegëse dhe mënyrën e sigurimit të tyre.....	13
9. Aktivitetet të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave etj.	14
10. Informacion për lejet, autorizimet dhe licencat e nevojshme për projektin	14
11. Kopje të dokumentave zyrtare që disponon zhvilluesi për projektin e propozuar, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin.....	14

FURNIZIM ME UJË I FSHATRAVE ÇERENEC I SIPËRM DHE I POSHTËM

Lista e figurave

Figura 1: Gjurma e objektit (Burimi ASIG).....	Error! Bookmark not defined.
Figura 2: Gjendja ekzistuese e ujesjlesit	Error! Bookmark not defined.
Figura 3: Planimetria e Pergjithshme.....	Error! Bookmark not defined.
Figura 4: Globe Valve.....	Error! Bookmark not defined.
Figura 5: Skema e modelit hidraulik.....	Error! Bookmark not defined.
Figura 6: Pamje e rrjetit te ujesjellesit te modeluar ne WaterGems.....	Error! Bookmark not defined.
Figura 7: Rrjeti i ujesjellesit i projektuar ne kuote 395-450m	Error! Bookmark not defined.
Figura 8: Skema hidraulike	Error! Bookmark not defined.
Figura 9: Vlefshmeria e modelit	Error! Bookmark not defined.
Figura 10: Detaj presionet ne rrjet ne periudhen e konsumit maksimal.....	Error! Bookmark not defined.
Figura 11: Llogaritja e mureve.....	Error! Bookmark not defined.

Lista e tabelave

Tabela 1: Konsumatoret kryesore	Error! Bookmark not defined.
Tabela 2: Konsumi per konsumatore te ndyshem.....	Error! Bookmark not defined.
Tabela 3: Prurjet maksimale	Error! Bookmark not defined.
Tabela 4: Volumet e akumuluar hyrese dhe dalese.....	Error! Bookmark not defined.
Tabela 5: Te dhenat e ngarkuara ne model per tubacionin PE100-RC.....	Error! Bookmark not defined.
Tabela 6: Te dhenat e ngarkuara per nyjet.....	Error! Bookmark not defined.
Tabela 7: Faktori jouniformitetit.....	Error! Bookmark not defined.

Lista e grafikëve

Grafiku 1: Manovrimi i saracineskes fundore ne hyrje te rezervuarit.....	Error! Bookmark not defined.
Grafiku 2: Te dhenat per nyjet	Error! Bookmark not defined.
Grafiku 3: Konsumi	Error! Bookmark not defined.
Grafiku 4: Ecuria e nivelit te ujit ne Rezervuar	Error! Bookmark not defined.
Grafiku 5: Diagrama sforcim deformim i çelikut	Error! Bookmark not defined.

1. QËLLIMI I PROJEKTIT

FURNIZIM ME UJË I FSHATRAVE ÇERENEC I SIPËRM DHE I POSHTËM

Ky projekt zbatimi konsiston në hartimin e nje projekti me qellim ndertimin e rrjetit te ujesjellesit ne fshatrat Çerenec i Sipërm dhe Çerenec i Poshtëm Njësia Administrative Gjorice, Bashkia Bulqizë.

Hartimi i ketij projekti i jep zgjidhje :

- Furnizimit me uje te pijshem per sot dhe ne prespektiven 25-vjecare me objektivi furnizimin 24 ore ne dite per Çerenec i Sipërm dhe Çerenec i Poshtëm .
- Ndertimin e rrjetit te ujesjellesit per Çerenec i Sipërm dhe Çerenec i Poshtëm.
- Furnizimi me uje me cilësi , referuarvendim ,nr. 379, datë 25.5.2016 për (Council Directive 98/83/EC of November 1998 on the quality of water intended for human consumption) dhe rekomandimeve për cilësinë e ujit nga Organizata Botërore e Shëndetësisë.
- Garantimin e fleksibilitetit të furnizimit me ujë, në rast avarie.
- Sigurimin e presioneve të nevojshme në rrjetin shpërndarës sipas zonave të furnizimit.

2. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT TË PROPOZUAR

- NE FAZEN E PARE TE KRYERJES SE PUNIMEVE PER OBJEKTI: “NDËRTIM RRJETI SHPËRNDARËS UJËSJELLËSI FSHATRAVE GJORICË DHE OSTREN SI DHE NDËRTIM DEPO UJI BASHKIA BULQIZË” JANE KRYER PUNIMET E PJESESHME, PER ARSYE SE NGA FONDI TOTAL I OBJEKTIT ME VLERE **320.066.401 LEKË**, U MIRATUAN VETEM **230.000.000 LEKE**.
- **PER KETE ARSYE U HOQEN NGA SKEMA E INVESTIMIT :**
 - **RRJETI SHPERNDARES I FSHATIT ÇERENEC I SIPËRM DHE NDËRTIM DEPO UJI**
 - **RRJETI SHPERNDARES I FSHATIT ÇERENEC I POSHTËM DHE NDËRTIM DEPO UJI**
- VENDOSJA E MATESAVE FAMILJARE NE FSHATIN LLADOMERICË (FAMILJE 76, BANORE 1548),
- VENDOSJA E MATESAVE FAMILJARE NE FSHATIN MIRESH (FAMILJE 62, BANORE 1548),
- VENDOSJA E MATESAVE FAMILJARE NE FSHATIN VICISHT I EPËRM
- VENDOSJA E MATESAVE FAMILJARE NE FSHATIN VICISHT I POSHTËM (FAMILJE 166, BANORE 695),
- VENDOSJA E MATESAVE FAMILJARE NE FSHATIN CERENEC I EPËRM (FAMILJE 136, BANORE 478),
- VENDOSJA E MATESAVE FAMILJARE NE FSHATIN CERENEC I POSHTËM (FAMILJE 216, BANORE 776)

FURNIZIM ME UJË I FSHATRAVE ÇERENEC I SIPËRM DHE I POSHTËM

- VLERA E MBETUR PA FINANCUAR, QE KERKOHET PER PERFUNDIMIN E PUNIMEVE ESHTË : **90.066.401 LEKË**

1. Të përgjithshme

Fshatrat Lladomericë (Familje 76, banore 1548), Miresh (Familje 62, banore 1548), Vicisht i Epërm dhe i Vicisht i Poshtëm (Familje 166, banore 695), Cerenec i Epërm (Familje 136, banore 478), Cerenec i Poshtëm (Familje 216, banore 776), Gjoricë e Epërme (Familje 407, banore 1548) dhe Gjoricë e Poshtme (Familje 392, banore 1404), ndodhen në pjesën lindore të Bashkisë Bulqizë, pranë kufirit të republikës së Shqipërisë me atë të Maqedonisë. Ndodhen në një zonë që karakterizohet nga klima kontinentale, me dimër të ashpër, dhe verë të nxehtë. Temperaturat variojnë nga -15 °C në dimër dhe + 36 °C në verë.

Popullsia

Nr.	Emri i Fshatit	Nr. Banore	Nr. Familje	Shkolla	Nr. nxenes	Q.SH ose Ambulance
1	Gjorice e sipërme	1548	407	9 vjeçare	339	QSH
2	Gjorice e poshtme	1404	392	9 vjeçare	48	Ambulance
3	Çerenec i sipërm	478	136	Fillore	22	Ambulance
4	Çerenec i poshtëm	776	216	Fillore	22	Ambulance
5	Vicisht	695	166	Fillore	85	Ambulance
6	Miresh	63	15	Fillore	18	Ambulance
7	Lladomericë	428	115	Fillore	26	Ambulance

Këto fshatra janë pjesë e njësive administrative Gjoricë dhe Ostren me një popullsi totale prej 6403 banorë.

Këto fshatra nuk kanë urbanistikë shumë të zhvilluar. Jo të gjitha rrugët janë të shtruara me asfalt, gjithashtu mungojnë sheshet si edhe objekte të mëdha industriale.

FURNIZIM ME UJË I FSHATRAVE ÇERENEC I SIPËRM DHE I POSHTËM



Aktualisht këto fshatra furnizohen nga burime me sasi uji jo të mjaftueshme për banorët dhe për institucionet që ndodhen në atë zonë, madje në periudhat e pikut këto burime pothuajse shterojnë totalisht. Mungesa e sasisë së nevojshme të ujit për ti plotësuar kërkesat ka detyruar që shumë familje të sigurojnë ujin e pijshëm duke hapur puse 5-6 m të thellë. Nga inspektim i bërë nga inspektoriati shtetëror sanitar, rezulton të kemi prani të lartë të ndotjes, e cila është shkaktuar nga përzierja apo pentrimi i ujërave të ndotur urbanë apo ujërave të ndotur atmosferik, me ujin e pijshëm. Gjithashtu është konstatuar se uji që përdoret për ujë të pijshëm është i patrajtur me klor.

FURNIZIM ME UJË I FSHATRAVE ÇERENEC I SIPËRM DHE I POSHTËM



Në kuadër të zhvillimit të rrjetit të ujësjellësit për këto fshatra është ndërtuar vepra e marrjes në fshatin Ostren i Vogël i cili siguron prurjen e nevojshme si edhe është ndërtuar tubacioni kryesor i furnizimit të depove, të cilat do të furnizohen me rrjedhje të lirë.

2. Objekti i Veprës

Objekti i kësaj Vepre Teknike është ndërtimi i rrjetit shpërndarës si edhe ndërtimi i depove përkatëse për secilin fshat. Ndërhyrja në këtë zonë bëhet për të:

- Ndërtimin e depove të ujit,
- Furnizuar me ujë zonën e banuar,
- Përmirësuar sasinë së ujit për frymë,
- Përmirësuar cilësinë e ujit,
- Ndërtimin e dhomës së klorinimit

FURNIZIM ME UJË I FSHATRAVE ÇERENEC I SIPËRM DHE I POSHTËM

Projekti ka marrë në konsideratë gjendjen ekzistuese dhe ka kryer matjet topografike të nevojshme të realizuar me GPS.



3. Gjendja Ekzistuese e Furnizimit të fshatrave.

Fshatrat furnizohen me tuba individualë të cilat furnizohen nga krojet më të afërta ose në rast mungese të burimeve, banorët kanë ndërtuar puse pranë objekteve apo tokave të tyre bujqësore. Deri me tani, keto fshatra nuk kane patur asnjehere investim per furnizim me uje te tyre. Ne vitin 2015, me fonde te UKUM eshte bere vetem rrjeti kryesor i furnizimit me uje, pa perfshire Ndertimin e depove te ujit per cdo fshat dhe rrjetin shperndares. Keto vendburime janë të kontaminuara nga filtrimet e ujërave të zeza, gjithashtu kanë një ndotje të theksuar nga mikroorganizmat biologjikë.

4. Llogaritjet e nevojave për ujë.

Për përcaktimin e prurjeve karakteristike përdorim formulat e mëposhtme :

- **Prurja mesatare ditore** -
$$Q_{mes}^d = \frac{N \cdot n}{1000} \text{ m}^3/\text{ditë}$$

N – Numri i popullsisë në fund të kohës së projektimit

P – Numri aktual i popullsisë banorë

i – Shtesa natyrore e popullsisë 2.5 %

t – Periudha e projektimit – 25 vjet

n – Norma e furnizimit mesatarisht ditore – 150 l/d/banorë

- **Prurja mesatare orare** -
$$Q_{mes}^d = \frac{Q_{mes}^d}{24} \text{ m}^3/\text{ore}$$

- **Prurja mesatare ne sekond** -
$$q_{mes.sek} = \frac{N \cdot n}{3.6 \cdot 24} \text{ l/s}$$

- **Prurja maksimale ne sekond** -
$$q_{max.sek} = q_{mes.sek} \cdot K_O \text{ l/s}$$

FURNIZIM ME UJË I FSHATRAVE ÇERENEC I SIPËRM DHE I POSHTËM

K_0 – Koeficienti i jouniformitetit $KO = 2.0$

Bazuar në detyrën e projektimit rritja e popullsisë është marrë 2.5% dhe norma e konsumit të ujit për banorë është pranuar 150 l/ditë/banor

5. Llogaritjet hidraulike të veprës .

Llogaritjet hidraulike të linjës së dërgimit janë bërë me anë të formulës Hazen-Williams që ka formën e mëposhtme :

$$Q = V * A$$

$$V = k C R^{0.63} S^{0.54}$$

Q – Prurja që kalon në tub

A – Sipërfaqja e prerjes tërthore të tubit

k – Koeficienti i konvertimit te sistemeve unitare

R – Rrezja hidraulike e tubacionit

S – Gradienti hidraulik

C – Koeficienti Hazen-Williams (koef. ashpërsise)

V – Shpejtësia e lëvizjes së ujit

C – Koeficienti i ashpërsisë që për tubacionet plastike është $C = 150$.



Llogaritjet janë bërë me programin kompjuterik Watercad.

FURNIZIM ME UJË I FSHATRAVE ÇERENEC I SIPËRM DHE I POSHTËM

Tabela e tubave

TABLE OF PIPE DIMENSIONS

PE 100 RC MULTILAYER PIPE



DN/ OD (mm)	SDR 17 S 8 *PN 10		SDR 11 S 5 *PN 16		SDR 9 S 4 *PN 20		SDR 7.4 S 4 *PN 25		SDR 6 S 2.5 *PN 32	
	s (mm)	WEIGHT (kg/m)	s (mm)	WEIGHT (kg/m)	s (mm)	WEIGHT (kg/m)	s (mm)	WEIGHT (kg/m)	s (mm)	WEIGHT (kg/m)
25	2.0	0.137	2.3	0.171	3.0	0.200	3.5	0.240	4.2	0.278
32	2.0	0.187	3.0	0.272	3.6	0.327	4.4	0.386	5.4	0.454
40	2.4	0.295	3.7	0.430	4.5	0.509	5.5	0.600	6.7	0.701
50	3.0	0.453	4.6	0.666	5.6	0.788	6.9	0.936	8.3	1.09
63	3.8	0.721	5.8	1.05	7.1	1.26	8.6	1.47	10.5	1.73
75	4.5	1.02	6.8	1.47	8.4	1.76	10.3	2.09	12.5	2.44
90	5.4	1.46	8.2	2.12	10.1	2.54	12.3	3.00	15.0	3.51
110	6.6	2.17	10.0	3.14	12.3	3.78	15.1	4.49	18.3	5.24
125	7.4	2.76	11.4	4.08	14.0	4.87	17.1	5.77	20.8	6.75
140	8.3	3.46	12.7	5.08	15.7	6.11	19.2	7.25	23.3	8.47
160	9.5	4.52	14.6	6.67	17.9	7.96	21.9	9.44	26.6	11.0
180	10.7	5.71	16.4	8.42	20.1	10.1	24.6	11.9	29.9	14.0
200	11.9	7.05	18.2	10.4	22.4	12.4	27.4	14.8	33.2	17.2
225	13.4	8.93	20.5	13.1	25.2	15.8	30.8	18.6	37.4	21.8
250	14.8	11.0	22.7	16.2	27.9	19.4	34.2	23.0	41.6	27.0
280	16.6	13.7	25.4	20.3	31.3	24.3	38.3	28.9	46.5	33.8
315	18.7	17.4	28.6	25.6	35.2	30.8	43.1	36.5	52.3	42.7
355	21.1	22.1	32.2	32.5	39.7	39.1	48.5	46.3	59.0	54.3
400	23.7	28.0	36.3	41.3	44.7	49.6	54.7	58.8	66.5	68.9
450	26.7	35.4	40.9	52.3	50.3	62.7	61.5	74.4	75.2	89.41
500	29.7	43.8	45.4	64.5	55.8	77.3	67.7	92.88	83.5	110.3
560	33.2	54.8	50.8	80.8	62.5	99.7	75.8	116.5	93.5	138.3
630	37.4	69.4	57.2	102	70.3	126.16	85.3	147.38	105	174.78
710	42.1	89	64.5	130	79.3	160.2	-	-	-	-
800	47.4	113	72.6	168.9	89.3	197	-	-	-	-

5. Përshkrim i Shkurtër i Veprave

FURNIZIM ME UJË I FSHATRAVE ÇERENEC I SIPËRM DHE I POSHTËM

Ky projekt parashikon ndërtimin e linjave të reja shpërndarëse si edhe ndërtimin e depove, përkatësisht:

Depo Uji 50 m³ dhe rrethim (6 copë) për fshatrat Lladomericë, Mireshe, Terbaç, Viçisht i Epërm, Viçisht i Poshtëm, Cerenec i Epërm dhe Cerenec i Poshtëm,

Depo Uji 500 m³ dhe rrethim për fshatrat Gjoricë e Epërme dhe Gjoricë e Poshtme.

Depot e ujit do të ndërtohen në pikat më të larta të përcaktuar në vizatimet e projektit në mënyrë që të sigurohet presioni i nevojshëm për çdo subjekt që do të furnizohet. Cdo depo do jetë e rrethuar dhe muret e depos do jenë të hidroizuara në mënyrë që të mos kemi infiltrime të ujëra nëntokësorë apo sipërfaqësorë. Shpërndarja e ujit nga depo deri te objektet do të realizohet me rrjedhje të lirë dhe me tuba PE 100 RC, të cilët kanë rezistencë më të lartë ndaj goditjeve. Përgjatë linjës shpërndarëse do të kemi të instaluar ajruer dhe shkarkues si edhe do kemi të instaluar saracineska të cilat do të manovrohen në rast avarie. Shpërndarja e ujit nëpër objektet e banimit do të realizohet me puseta nëntokësore në mënyrë që matësat e vendosur në pusetë të jenë të mbrojtur ndaj ngricave. Pusetat do të jenë me 4,6 dhe 10 dalje. Cdo pusetë do të ketë kapak llamarine të xinguar dhe muret e pusetës do jenë betonarme të papërshkueshëm nga uji.

Tubacionet që do të përdoren do të jenë të presionit 10 dhe 16 atmosfer.

Duke qënë se linjat kalojnë në rrugë kryesore, gjatë gërmimit të kanaleve dhe i gërmuar do të largohet dhe mbushja e kanalit do të bëhet me zhavorr për të pëmirësuar parametrat e rrugës dhe evituar dëmtimet e mundëshme nga cedimet e rrugës. Në rrugët e asfaltuara aksi i instalimit të tubacionit do të jetë pranë kuneve të ujërave të shiut, në mënyrë që të pengohet sa më pak qarkullimi i automjeteve gjatë fazës së ndërtimit. Cdo dëmtim i infrastrukturës do të rikthehet në gjendjen e mëparshme sipas kushteve teknike të përcaktuara.

Volumet kryesore të punimeve janë si më poshtë;

1. Ndërtim depo 500 m³ - 1 copë
2. Ndërtim depo 50 m³ - 6 copë
3. Ndërtim linje shpërndarëse

1	Germim kanali me makineri	m ³	16031.5
2	Germim kanali me krahe	m ³	6870.65
3	Transport dheu deri 5 km	m ³	3817.03
4	Prerje asfalt	m ²	2000.84
5	Shtrese Asfatobetoni 4 cm	m ²	2000.84
6	Shtrese Bineri t=6 cm	m ²	2000.84
7	Shtrese çakulli mbeturine, t=10 cm	m ²	2000.84
8	Shtrese stabilizanti t=20 cm	m ²	2000.84
9	Mbushje ngjeshje me zhavorr	m ³	3817.03
10	Mbushje me material të gërmuar me pare	m ³	19085.1
11	F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PE 100 RC Ø160 mm PN 16	ml	535.5
12	F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PE 100 RC Ø160 mm PN 10	ml	397.6
13	F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PE 100 RC Ø140 mm PN 10	ml	1331.8
14	F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PE 100 RC Ø125 mm PN 10	ml	3804.6
15	F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PE 100 RC Ø110 mm PN 10	ml	3765.8
16	F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PE 100 RC Ø90 mm PN 10	ml	5268.3

FURNIZIM ME UJË I FSHATRAVE ÇERENEC I SIPËRM DHE I POSHTËM

17	F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PE 100 RC Ø75 mm PN 10	ml	2739.7
18	F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PE 100 RC Ø63mm PN 10	ml	2646.9
19	F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PE 100 RC Ø50 mm PN 10	ml	3000.8
20	F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PE 100 RC Ø40 mm PN 10	ml	9021.9
21	F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PE 100 RC Ø75 mm PN 16	ml	1906.4
22	F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PE 100 RC Ø63mm PN 16	ml	814.0
23	F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PE 100 RC Ø50 mm PN 16	ml	1659.8
24	F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PE 100 RC Ø40 mm PN 16	ml	3335.9

4. Kalim kanali – 3 copë
5. Puseta komandimit – 18copë
6. Pusete Ajrimi – 22 copë
7. Pusete Shkarkimi – 6 copë
8. Pusete shperndarese Tip 4 (me 4 dalje) – 0 copë – Zevendesohen me Matesa
9. Pusete shperndarese Tip 6 (me 6 dalje) – 0 copë – Zevendesohen me Matesa
10. Pusete shperndarese Tip 10 (me 10 dalje) –0 copë – Zevendesohen me Matesa

6. Konkluzione

Projekti i mësipërm ka rëndësi të madhe për zonën pasi është një zonë banimi në të cilën numri i popullsisë është rritur ndjeshëm , ndërsa investimet kanë qenë të pakta. Dhe duke marrë në konsideratë dhe faktin që linja shpërndarëse do të shërbejë për të furnizuar bizneset përgjatë kësaj linje, atëherë duke ndërtuar një rrjet të ri furnizimi për zonën do të furnizojë rregullisht banorët me ujë.

Ky projekt ka këto anë pozitive.

1. Furnizimin me ujë të banorëve në fshatrat Cereneç i Epërm, Cereneç i Poshtëm
2. Në thjeshtësinë e veprës, si në konstruktimin e saj, ashtu edhe në funksionimin e vepres.
3. Ndërtimin e depove të ujit për secilin fshat, për të siguruar prurjen dhe presionin e nevojshëm.
4. Do bëhet i mundur trajtimi me klor i ujit për të siguruar cilësinë e tij.
5. Do të sigurojë furnizim 24 orë për secilin banor pasi do instalohet matës në secilën familje.

3. Programi për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar për funksionimin e projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe, sipas rastit, edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes, pas mbarimit të funksionimit të projektit

FURNIZIM ME UJË I FSHATRAVE ÇERENEC I SIPËRM DHE I POSHTËM

Punimet parashikohen të zgjasin 6 muaj. Kjo është koha normale që duhet për të përfunduar punimet në kushte normale. Kjo periudhë është e vlefshme në kushte teknike, juridike e klimë normale, por në rast se do të hasen vështirësi gjatë punimeve mund të ketë edhe shtyrje të afatit.

4. Lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyra e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji)

Lëndet e para të përdorura do të jenë kryesisht:

- B/A
- Materiale hekuri dhe çeliku
- Hekur
- Bojë

5. Informacioni për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zonës së projektit

Përveç projektit në fjalë, nuk ka asnjë projekt tjetër ndërtimor ose infrastrukturor që zhvillohet në zonë dhe që mund të kondiciononte ecurinë dhe kohëzgjatjen e tij.

6. Informacioni për alternativat e marra në konsideratë, për sa i takon përzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret.

Përsa u përket alternativave lidhur me vendndodhjen, nuk ka të tilla, pasi projekti do të zhvillohet në rrugën ekzistuese.

7. Të dhënat për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasi të ujit të dhe nevojshëm, të energjisë, lëndëve djegëse dhe mënyrën e sigurimit të tyre

Gjatë funksionimit të veprimtarisë do të kemi përdorim të lëndëve të para si më poshtë:

- Ujë për nevojat sanitare afërsisht 1-3 m³/ditë.
- Energji elektrike për furnizimin e pajisjeve elektronike dhe elektrike dhe për ndriçimin e ambienteve të magazinës dhe shërbimit, e cila sigurohet nga OSHEE.

8. Aktivitetet të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave etj.

Për realizimin e projektit, nuk nevojiten aktivitete të tjera, si p.sh ndërtimi i kampeve ose rezidencave në kantier.

9. Informacion për lejet, autorizimet dhe licencat e nevojshme për projektin

Per zhvillimin e projektitshoqëria ka përgatitur dokumentacionin e kërkuar për tu pajisur me Vendim per VNM Paraprake, referuar shtojces II të Ligjit Nr. 10 440, date 07.07.2011 “Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis” të ndryshuar.

Pas përfundimit të projektit në rast se do të kemi aktivitete që bëjnë pjesë në shtojcën 1 të ligjit për lejet e mjedisit, atëherë, ka nevojë të aplikojë për tu pajisur me Leje Mjedisit të tipit B, referuar shtojces 1, te Ligjit Nr. 52/2020, Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 448, date 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” të ndryshuar”.

Pas marrjes së Vendimit për VNM Paraprake nga subjekti do të bëhet aplikimi për leje ndërtimi sipas kriterëve dhe kërkesave përkatëse ligjore.

10.Kopje të dokumentave zyrtare që disponon zhvilluesi për projektin e propozuar, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin.

Perfaqesuesi Grupit tepunes te Hartimit te Raportit te VNM-se
Eksperti VleresimitteNdikimitneMjedisVendimNr.122,nr.5244 Prot., dhe

Nr. identifikues 581dt.23.06.2017

Ing. Gezim ISLAMI